

“Mekanizmat Kryesorë të Reziliencës së Familjes në Kosovë”

Tema për titullin
MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

nga

Mjellma Berisha



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
Departamenti i Psikologjisë
Prishtinë

Korrik, 2024

Mentore: Prof. Asoc. Dr. Kaltrina Kelmendi

Rezilienca përkufizohet si kapaciteti për t'u rimëkëmbur nga vështirësitë e jetës, duke përfshirë proceset që mundësojnë përshtatjen pozitive dhe përballjen pavarësisht sfidave të mëdha (Southwick et al., 2014; Masten, 2001; Wright et al., 2012). Ndërsa rezilienca familjare i referohet familjes si një sistem funksional që ndikohet nga stresues dhe kontekste sociale, duke lehtësuar përshtatjen pozitive të të gjithë anëtarëve dhe forcimin e njësisë familjare (Walsh, 2015). Sipas Walsh (2003), proceset kryesore që nxisin reziliencën në familje janë sistemet e besimit, proceset organizative dhe proceset e komunikimit. Ky hulumtim ka për qëllim të gjejë ndikimin dhe ndërlidhjen e mekanizmave kryesorë të reziliencës së familjes në mirëqenien subjektive si dhe të identifikojë dallimet midis tri grupmoshave tek këto mekanizma. Prandaj, pyetjet kërkimore në kuadër të këtij hulumtimi janë:

PK1: Cila është ndërlidhja midis mekanizmave kryesorë të reziliencës së familjes (sistemet e besimit, proceset organizative dhe proceset e komunikimit) dhe mirëqenies subjektive të individit?

PK2: Si ndikojnë mekanizmat kryesorë të reziliencës së familjes (sistemet e besimit, proceset organizative dhe proceset e komunikimit) në mirëqenien subjektive të individit?

PK3: Cili është dallimi në mekanizmat kryesorë të reziliencës së familjes (sistemet e besimit, proceset organizative dhe proceset e komunikimit) tek grupmoshat e ndryshme (18-24 vjeç, 25-42 vjeç dhe 43-63 vjeç)?

Studimet të cilat janë zhvilluar mbi familjet që kanë përjetuar fatëkeqësi të ndryshme tregojnë se rezilienca familjare ka një ndërlidhje dhe ndikim pozitiv në mirëqenien subjektive (Neo et al., 2016; Yousefi Afrashteh et al., 2024; Paleari et al., 2023; Qi & Yang, 2024). Poashtu, hulumtimet kanë theksuar se nivelet e reziliencës së familjes dallojnë tek grupmoshat e ndryshme, duke theksuar se personat më të moshuar paraqesin nivele të larta të reziliencës, përkundrajt të rinjëve që paraqesin nivele më të ulëta për shkak të përdorimit të mekanizmave të tjerë mbrojtës

(Walsh, 2021; Hamza et al., 2023; Angeles & Perkins, 2023). Duke u bazuar në këto informata janë formuluar edhe hipotezat e këtij hulumtimi të cilat janë:

H1: Ekziston një ndërlidhje signifikante pozitive midis mekanizmave kryesorë të reziliencës së familjes (sistemet e besimit, proceset organizative dhe proceset e komunikimit) dhe mirëqenies subjektive të individit.

H2: Mekanizmat kryesorë të reziliencës së familjes (sistemet e besimit, proceset organizative dhe proceset e komunikimit) kanë ndikim signifikant pozitiv në mirëqenien subjektive të individit.

H3: Ekziston një dallim signifikant në mekanizmat kryesorë të reziliencës së familjes (sistemet e besimit, proceset organizative dhe proceset e komunikimit) midis grupmoshave të ndryshme (18-24 vjeç, 25-42 vjeç dhe 43-63 vjeç).

Për t'i testuar hipotezat, ky hulumtim kuantitativ dhe ndërseksional është realizuar me 234 pjesëmarrës nga komuna të ndryshme të Kosovës. Për përzgjedhjen e tyre është përdorur metoda e topit të borës. Minimumi i moshës së pjesëmarrësve ka qenë 18 vjeç ndërsa maksimumi 63 vjeç ($M=35$, $SD= 13.7$). Metoda e përdorur ka qenë anketimi ku pyetësorët janë shpërndarë në formë elektronike me anë të Google Forms. Instrumentet e përdorura janë Pyetësori i Reziliencës së Familjes nga Walsh (WFRQ) dhe shkalla e mirëqenies subjektive marrë nga Pyetësori Portfolio i Reziliencës nga Hamby (RPQ). Analiza e të dhënave është bërë përmes platformës IBM SPSS 23 me anë të cilës janë aplikuar korrelacioni, regresioni dhe ANOVA. Në këtë hulumtim janë ndjekur të gjitha parimet etike, duke i informuar pjesëmarrësit për qëllimin e studimit, ruajtjen e konfidencialitetit dhe lirinë për t'u tërhequr nga studimi në çdo moment.

Rezultatet e analizës së korrelacionit Pearson treguan se sistemet e besimit ($r(232)= .454$, $p < .01$), proceset organizative ($r(232)= .607$, $p < .01$) dhe proceset e komunikimit ($r(232)= .576$, $p < .01$) kanë korrelacion signifikant pozitiv me mirëqenien subjektive duke e mbështetur kështu

plotësisht hipotezën e parë. Analiza e regresionit të shumëfishtë linear fillimisht tregoi se modeli i përgjithshëm ishte signifikant, $F(3, 230) = 49.166, p < .001$, me $R^2 = .391$, duke treguar gjithashtu se 38.3% e ndryshueshmërisë së mirëqenies subjektive mund të shpjegohet nga mekanizmat kryesorë të reziliencës së familjes. Më tej, u zbulua se proceset organizative ($\beta = .583, t = 4.61, p < .001$) dhe proceset e komunikimit ($\beta = .330, t = 2.9, p = .005$) kanë ndikim signifikant pozitiv në mirëqenien subjektive. Kurse sistemi i besimit familjar doli të jetë parashikues negativ i mirëqenies subjektive ($\beta = -.160, t = -1.90, p = .058$). Këto të dhëna tregojnë se hipoteza e dytë mbështetet pjesërisht.

Me aplikimin e ANOVA-s njëdrejtimëshe dhe testeve post-hoc të dallimit më pak signifikant (LSD) u gjet një dallim signifikant në pikët e sistemit të besimeve familjare midis grupmoshës më të re (18-24) dhe grupmoshës më të vjetër (43-63), ku grupi më i ri kishte pikë më të ulëta ($M = -2.78, SE = 1.41, p = 0.050$). Megjithatë, nuk u gjetën dallime signifikante midis grupmoshës së re (18-24) dhe grupit të moshës së mesme (25-42) ($M = -1.93, SE = 1.43, p = 0.176$), ose midis grupit të moshës së mesme (25-42) dhe grupmoshës më të vjetër (43-63) ($M = -0.85, SE = 1.44, p = 0.556$). Dallime signifikante u vërejtën në proceset e komunikimit dhe zgjidhjes së problemeve midis disa grupmoshave. Grupi më i ri i moshës (18-24) kishte pikë ndjeshëm më të ulëta krahasuar me grupin e moshës së mesme (25-42) ($M = -2.83, SE = 1.24, p = 0.023$). Për më tepër, grupi më i ri i moshës (18-24) gjithashtu kishte pikë ndjeshëm më të ulëta sesa grupi më i vjetër i moshës (43-63) ($M = -3.83, SE = 1.23, p = 0.002$). Nuk u gjet ndonjë dallim signifikant midis grupit të moshës së mesme (25-42) dhe grupit më të vjetër të moshës (43-63) ($M = -1.01, SE = 1.25, p = 0.423$). Tek proceset organizative të familjes nuk u gjetën dallime signifikante midis ndonjë grupmoshe. Nga kjo kuptohet se hipoteza e tretë mbështetet pjesërisht.

Një pjesë e konsiderueshme e rezultateve qëndrojnë në përputhshmëri me literaturën ekzistuese, duke theksuar edhe më tej rëndësinë e mekanizmave të reziliencës familjare në përmirësimin e mirëqenies subjektive. Përveç sistemit të besimit që përfaqëson mënyrën se si familjet i japin kuptim vështirësive, optimizmin, vlerat, qëllimet, besimet dhe praktikrat (Walsh, 2016), i cili kishte ndërlidhje pozitive me mirëqenien subjektive por ndikim negativ tek ajo ($\beta = -.160, t = -1.90, p = .058$). Kjo gjetje pasqyron natyrën komplekse të sistemit të besimeve që mund të sjellë harmoni brenda familjes por në të njëjtën kohë mund të dëmtojë mirëqenien e anëtarëve në momentin kur këto vlera nuk përshtaten ose nuk përmbushin pritshmëritë e familjes. Rezultatet mbi dallimet e grupmoshave gjithashtu sygjerojnë se proceset organizative të familjes qëndrojnë stabile nëpër të gjitha grupmoshat, kurse aspekti i komunikimit brenda familjes dhe sistemi i besimit përmirësohen me rritjen e moshës ose mund të jetë çështje e gjeneratave specifike. Pavarësisht arsyeve, këto gjetje janë të ngjashme me hulumtimet e zhvilluara nga autorët e tjerë.

Hulumtimet e ardhshme duhet të eksplorojnë më thellë natyrën komplekse të këtyre mekanizmave dhe ndërveprimin e tyre për një periudhë më të gjatë, duke përdorur metodën kualitative dhe dizajnin longitudinal. Bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi, rekomandohet zhvillimi i intervenimeve për përmirësimin e reziliencës familjare, me fokus të veçantë në komunikimin dhe sistemet e besimit. Duke i marrë parasysh nivelet më të ulëta të reziliencës tek të rinjtë, është e dobishme që intervenimet parandaluese të aplikohen edhe nga psikologët shkollorë. Psikologët shkollorë në Kosovë mund të krijojnë programe mbështetëse për fëmijët dhe prindërit e tyre, si dhe të organizojnë trajnime për përmirësimin e këtyre aspekteve brenda familjeve.